

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11 dhe neni 47 paragrafi 5 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/14 dhe 132/14), e në lidhje me nenin 15 paragrafi 7 alineja 7 dhe neni 39 paragrafi 1 alineja 11 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014 dhe në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-1783/5 nga data 12.03.2015, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale të Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e 10-të, të mbajtur më 12.03.2015, miratoi:

RREGULLORE
për mënyrën e udhëheqjes së evidencës ditore dhe për kualitetin e incizimeve nga programi i emetuar i radiodifuzerëve

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Lënda e Rregullores

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e udhëheqjes së evidencës ditore nga programi i emetuar dhe formati dhe kualiteti i incizimeve të programit të përgjithshëm që radiodifuzerët janë të obliguar që ti ruajnë së paku 60 ditë pas emetimit.

Neni 2
Definicionet

- Për nevojat e kësaj Rregullore, shprehje të caktuara, e kanë këtë domethënie:
- *Programi audiovizuel* paraqet një tërësi të fotografive lëvizëse me ose pa zë, që paraqet një element të veçantë në kuadër të renditjes kronologjike të programeve (skemës programore);
 - *Audio programi* paraqet përmbajtje muzikore dhe/ose biseduese që paraqet një element të veçantë në kuadër të renditjes kronologjike të programeve (skemës programore) të përcaktuar nga ofruesi i shërbimit mediatik të audios;
 - *Shërbimi programor* paraqet një tërësi të programeve dhe segmenteve tjera të një shërbimi të vetëm audio ose audiovizuel që e siguron një radiodifuzer konkret dhe që është e dedikuar për praninë nga ana e publikut;
 - *Program i prodhimit personal* është një program radio ose televiziv i krijuar me iniciativë dhe në organizim të vet radiodifuzerit, program i porositur nga radiodifuzeri (prodhim i porositur) ose i prodhuar në koproduksion;
 - *Llojet e programeve audio dhe audiovizuale* janë tërësi të krijuara me funksion argëtues, arsimor dhe informativ;
 - *Segmente tjera programore* në renditje kronologjike të programeve (skemë programore) janë përmbajtje që nuk kategorizohen si lloje të programeve;
 - *Sinjal dalës televiziv* është sinjali i pandërprerë që e transmeton radiodifuzeri nga pajisja dalës (TV transmetuesi) i vendosur në studion e tij deri te operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, operatori i multipleksit digjital terestrial ose operatorit satelitor, që në mënyrë burimore pa modifikime e emetojnë për shikim.
 - *Sinjal dalës i radios* është sinjali i pandërprerë që e transmeton radiodifuzeri në mënyrë burimore emetuesi i tij terestrial ose nga ndonjë pajisje të vendosur në studion e tij dhe e transmeton deri te pajisja e operatorit të rrjetit publik të

komunikimit elektronik, operatori i multipleksit dijgital terestrial ose te operatori satelitor, që në mënyrë burimore pa modifikime e emetojnë për shikim.

Neni 3

Obligimi për mbajtjen e evidencës ditore

Radiodifuzerët janë të obliguar që rregullisht të azhurnojnë dhe evidentojnë të dhënat për të gjitha programet e emetuara audio dhe audiovizuele edhe për segmentet e tjera të shërbimit programor.

Evidenca për programet e emetuara audio ose audiovizuele edhe për segmentet e shërbimit programor të udhëhiqet edhe në bazë ditore.

Radiodifuzeri është i obliguar që të emërojë së paku një person që do të jetë përgjegjës për udhëheqjen ditore te evidencës së përmbajtjeve të emetuara të shërbimit programor.

II. TË DHËNAT QË DUHET TI PËRMBAJ EVIDENCA DITORE E SHËRBIMEVE PROGRAMORE

Neni 4

Evidenca ditore e shërbimeve programore televizive

Evidenca ditore për programet e emetuara dhe segmente e tjerra të shërbimit programor të televizionit duhet të përmbajë këto të dhëna:

- datën e emetimit;
- kohën e emetimit;
- kohëzgjatjen e përgjithshme;
- titulli i përmbajtje së emetuar;
- emetimi premier ose reprizë (vlen vetëm për programet);
- lloji i programit audiovizuel ose segmentit programor (sipas Udhëzimit për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuele¹);
- llojin e prodhimit të programit audiovizuel (prodhimit personal ose programit të huaj);
- vendi i prodhimit (kur bëhet fjalë për programin e huaj);
- pronari i të drejtave (kur bëhet fjalë për program të huaj);
- muajji dhe viti i prodhimit;
- emri i producentit (nëse programi është i krijuar nga producent i pavarur).

¹ Udhëzimi për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuele, në të cilën referohet në nenet 4 dhe 5 të kësaj Rregullore, është publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" nr.<0} 171/14.

Neni 5

Evidenca ditore e shërbimeve programore të radios

Evidenca ditore e shërbimeve programore të radios duhet të përmbajë të dhëna për emetimin e tërësive biseduese, biseduese muzikore dhe atyre muzikore, si dhe për segmentet e tjera të shërbimit programor, edhe atë:

- datën e emetimit;
- kohën e emetimit;
- kohëzgjatjen e përgjithshme;
- titulli i përmbajtje së emetuar;
- lloji i audio programit ose segmentit programor (sipas Udhëzimit për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve audio dhe audiovizuele);
- llojin e prodhimit të programit të audios (prodhimit personal ose programit të huaj);
- vendi i prodhimit (kur bëhet fjalë për programin e huaj);
- muaji dhe viti i prodhimit;

Neni 6

Obligimi për parashtrimin e të dhënave për programin e emetuar

Radiodifuzerët duhet që rregullisht ta përcjellin plotësimin e obligimeve të tyre programore të përcaktuara me Ligj, aktet nënligjore dhe me konceptin programor që është pjesë përbërëse e lejes për emetim të shërbimit programor, në bazë të të dhënave të futura në evidencën ditore të programit të emetuar.

Me kërkesë të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, radiodifuzerët janë të obliguar që të dorëzojnë të parashtrajnë të dhëna për përmbajtjet e emetuara të shërbimit programor.

III. INCIZIMI I SINJALIT DALËS DHE KUALITETI I INCIZIMEVE NGA PROGRAMI I EMETUAR

Neni 7

Incizimi i sinjalit dalës

Radiodifuzerët janë të obliguar që ta incizojnë sinjalin dalës të programit të tyre të emetuar në formën sic shpërndahet përmes emetuesit terestrial, kapacitetit emetues të multipleksit digjital terestrial, rrjetit publik të komunikimit elektronik ose satelitit.

Sinjali dalës dhe sinjali që shikohet/dëgjohe te receptorët duhet të jenë identik.

Incizimi i sinjalit dalës bëhet çdo ditë, respektivisht fillohet në ora 00:00 dhe përfundon në ora 24:00.

Neni 8
Formati i incizimeve dhe obligimi për parashtrimin e tyre

Incizimet nga programi i emetuar, radiodifuzerët janë të obliguar që ti ruajnë së paku 60 ditë pas emetimit, të ruajtura në datoteka të shënuara sipas datës së emetimit të sinjalit dalës.

Me kërkesë të Agjencisë, radiodifuzerët janë të obliguar që në afat prej 3(tre) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, të dorëzojnë ndonjë prerje inserti ose incizim të integruar autentik nga programi i emetuar ditë, në një prej këtyre formateve: MP4 (H.264 AVC), AVI, ASF, ËMF ose ndonjë format tjetër digjital.

IV. DISPOZITAT PËRMBYLLËSE

Neni 9

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, pushon vlefshmëria e Rregullores për kushtet teknike gjatë incizimit të detyrueshëm, ruajtjes dhe dorëzimit të programit të emetuar ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 41/11).

Neni 10

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuale**

Kryetar i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Nr. 01-1878/1

12.03.2015

S h k u p